



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.6

Qershor 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 14.5.2004.

PROJEKTLIGJE

Projektvendim për miratimin e propozimit të projektligjit "Për ratifikimin e protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin."

Konventa penale kundër korrupsionit, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2001. Ratifikimi i protokollit shtesë të kësaj Konvente, mundëson plotësimin e sistemit ligjor për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit si dhe lejon zbatimin më të gjerë të Programit të veprimit kundër tij.

VENDIME të Këshillit të Ministrave

1. Për fillimin e procedurës së ndërtimit me konçension të hidrocentralit të Gizaveshit, Librazhd, si propozim i pakërkuar.

2. Për përcaktimin e personaliteteve të tjera të larta shtetërore, të cilat do të ruhen nga Garda e Republikës së Shqipërisë pas lirimit nga funksioni dhe për një ndryshim në vendimin nr.n 422, datë 12.9.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore." risigurimit etj.

3. Për caktimin e selive dhe të rezidencave, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Sh-

qipërisë organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të sigurimeve.

4. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.281, datë 2.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë".

5. Për ngritjen e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza".

6. Për disa shtesa në vendimin nr. 294, datë 13.6.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të Përdorimit të tokës në Portin e Durrësit".

7. Për disa ndryshime në vendimin nr. 408, datë 11.6.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për disa Çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Për domosdoshmërinë e plotësimit të kriterit të njohjes së gjuhës angleze nga ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për gradimin e radhës.

9. Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për bashkëpunim në fushat e shoqërisë

(Vijon në faqen 2)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave
faqe 1-2

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore
faqe 1

4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 16-31 maj 2004

faqe 3

5. Kalendarit 2 javor i Kuvendit, 7 - 17 qershor 2004
faqe 4-5

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

së informacionit, telekomunikacioneve dhe shërbimeve postare.

10. Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administratën e përkohëshme të Kosovës (UNMIK), në emër të institucioneve të përkohëshme vetëqeverisëse në Kosovë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve.

11. Për miratimin në parim të Marrëveshjes grant, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim, për përgatitjen e projektit "Parku Kombëtar i Butrintit – Biodiversiteti dhe ruajtja e trashëgimisë globale".

12. Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore.

13. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për mbikqyrjen e vazhdimet të punimeve të ndërtimit të segmentit rrugor Lezhë – Shkodër.

14. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit, të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 12 tetor 2003.

15. Për lejimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prodhimin e mjeteve levizëse për invalidë.

II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 21.5.2004.

PROJEKTLIGJE

Vendime të Këshillit të Ministrave për miratimin e propozimit të projektligjeve si më poshtë:

16. Për një shtesë në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993, "Për kundravajtjet administrative" të ndryshuar.

Me këtë shtesë kërkohet të miratohet lejimi i përdorimit të të ardhurave që realizohen nga gjokat e vëna psh. organet e policisë pyjore, nga të cilat 30% të kalojnë në favor të Drejtorisë së Përgjithëshme të

Pyjeve dhe Kullotave dhe 70% të kalojnë në favor të buxhetit të shtetit.

17. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për transportin ajror.

VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

1. Për caktimin e elementëve të sigurtë dhe miratimin e formës së dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë

2. Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit.

3. Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në masën e mbulimit të çmimit të tyre.

4. Për një shtesë në vendimin nr.352, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, "Përmiratimin e çertifikatave të pronësisë së pasurisë së paluajtshme" të ndryshuar.

5. Për një shtesë në vendimin nr.549, datë 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

6. Për disa shtesa në vendimin nr.325, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore".

7. Për kompensimin e qirasë së banesës për punonjësit e pastrehë të Gardës së Republikës së Shqipërisë, në rast transformimi.

8. Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelit të pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

9. Për disa shtesa në vendimin nr.579, datë 8.12.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet e dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar të ushtarakëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në rastet e nxjerrjes së tyre në rezervë, lirim apo pension".

10. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të degës së mobilizimit në qytetin e Librazhdit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003,

të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

11. Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë së zhvillimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e menaxhimit të burimeve ujore.

12. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Beratit.

13. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Lezhës.

14. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Gramshit.

15. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë e Divjakës.

16. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Tërbuf.

17. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ngraçan.

18. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fier-Shegan.

19. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Alliaj.

20. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Remas.

21. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ballagat.

22. Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin në pronësi të bashkisë së Fierit të uzinës së fermentimit të duhanit.

23. Pas një shtese fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, për dhënien e ndihmës financiare familjes së zonjës Olimbi Haxhaj.

24. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 11.7.2002 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publike", i ndryshuar.

25. Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-31 MAJ 2004

Raport i Këshillit të Ministrave për Shërbimin Civil 2003

Në Raport theksohet se gjatë vitit 2003 është forcuar dhe përmirësuar puna për zbatimin e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, si dhe është përmirësuar menaxhimi i shërbimit civil. Gjatë këtij viti janë bërë disa përmirësime në aktet ligjore ekzistuese, plotësime të bazës ligjore në disa fusha të parregulluara më parë dhe është shtrirë fusha e veprimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e tjera të administratës publike. Më tej, Raporti ndalet në zbatimin e ligjit nr.8549 dhe theksohet se ka përmirësime në procedurat e pranimit në shërbimin civil, gjë që duket në faktin e uljes së numrit të ankimeve ndaj procedurave të konkurimit, si dhe në uljen e procedurave të ankimit të anuluar. Më tej, vihen në dukje disa dobësi në procesin e pranimit në punë. Në analizën që i bëhet reformës në fushën e pagave vihet në dukje zbatim i sistemit të ri të pagave për disa kategori të nëpunësve dhe rishikimi i sistemit të pagave në disa sisteme prioritare. Nga analiza e sistemit aktual të pagave, rezulton se ka disa mangësi në procedurat ligjore për caktimin e pagave të institucioneve të pavarura, ku kompetenca për caktimin e tyre është e shpërndarë në disa institucione ose përcaktohet në ligjin e organizimit dhe funksionimit të tyre. Në përfundim, Raporti pasqyron rezultatet e punës së Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

Gjatë diskutimit për Raportin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, deputetët e maxhorancës e vlerësuan atë dhe e konsideruan zbatimin e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” të suksesshëm”. Ata theksuan se shtrirja e fushës së veprimit të rregullave të menaxhimit të shërbimit civil në sistemin e rekrutimit ka sjellë rritjen e transparencës së procedurave, shpejtimin dhe lehtësimin e tyre, uljen e mundësisë së subjektivizmit në të gjitha hallkat e përzgjedhjes. Ata përmendën edhe drejtimit kryesorë ku do të përqëndrohet puna në të ardhmen si rritja e profesionalizmit të nëpunësve, nëpërmjet zbatimit të drejtë të kritereve ligjore, përmirësimi i procesit të konkurimit dhe vendosja e tij mbi baza transparente, profesionale e të merituar, rritja e qëndrueshmërisë së administratës, përsosja e sistemit të trajnimit dhe vlerësimit, si dhe zbatimi i ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” edhe në njësitë e qeverisjes vendore.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan Raportin dhe vunë në dukje mangësitë në zbatimin e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”. Ata përmendën ndërhyrjen politike në administratën publike dhe nepotizmin që e karakterizon atë, mohimin e të drejtave të qytetarëve të aftë për të zënë një vend të merituar në administratën shtetërore, korrupsionin, ndryshimet e shpeshta të personelit, paragjykimet në procesin e konkurimit, të cilat e kthejnë atë në një proces formal, pamjaftueshmërinë e kuadrit ligjor për administratën publike, mangësitë në procedurat e marrjes në punë, sistemin e karrierës, emërimet subjektive etj.

P/ligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave”

Kuvendi shqyrtoi në seancë plenare dy nisma ligjvënëse, njëren të paraqitur nga deputetët Maksim Begeja dhe Alfred Çako dhe tjetrën të paraqitur nga një grup deputetësh mbi bazën e projektligjit të hartuar nga një grup pune nën asistencën e ekspertëve të OSCE-së.

Nismëtarët e projektligjit Begeja dhe Çako argumentuan domosdoshmërinë e projektligjit të paraqitur prej tyre, i cili sipas tyre, zgjidh përfundimisht problemin e kthimit të pronave pronarëve të ligjshëm, duke parashikuar kompensim fizik apo monetar vetëm në rastet e shpronësimeve për nevoja publike. Ata theksuan se ky koncept është në përputhje të plotë me nenin 41 të Kushtetutës dhe me dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sipas tyre, ky projektligj synon të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi ligjore midis pronarëve të ligjshëm dhe personave të tretë që ndodhen në pronën e tyre që, me ndërmjetësinë e shtetit, të shpërblejnë reciprokisht njeri-tjetrin pa rënduar buxhetin e shtetit. Pra, sipas tyre, fatura financiare duhet të ndahet në tri pjesë, midis pronarëve të vjetër, pronarëve të rinj dhe shtetit. Ata vlerësuan projektligjin e paraqitur prej tyre si variantin më të mirë, për faktin se ai shoqërohet me faturë financiare të vogël dhe të përballueshme nga Buxheti i Shtetit.

Varianti i paraqitur nga deputetët Mediu dhe Çako nuk u miratua nga shumica e deputetëve, të cilët mbështetën variantin e paraqitur nga grupi i deputetëve nën asistencën e OSCE-së. Ky variant u kundërshtua në parim nga një pjesë e deputetëve për tri çështje themelore:

- Ai mban në fuqi ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, si dhe disa ligje të tjera që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat, sipas tyre, bien në kundërshtim me Kushtetutën;
- Nuk parashikon kthimin fizik tek pronarët të trojeve të zëna me ndërtime të paligjshme gjatë dekadës së fundit;
- Varianti i miratuar nga shumica e deputetëve nuk përfshin kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme.

Shumica e deputetëve mbështetën në parim variantin e projektligjit të paraqitur nga një grup deputetësh nën asistencën e OSCE-së. Pas miratimit në parim, Kuvendi filloi shqyrtimin e këtij projektligji nen për nen, duke marrë parasysh vërejtjet e komisioneve të përhershme të Kuvendit për riformulime e ndryshime në to.

Krahas vërejtjeve të Komisioneve, Kuvendi shqyrtoi edhe disa amendamente për ndryshime ose riformulime në disa nene të projektligjit, të paraqitura nga grupe parlamentare dhe deputetë. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit vazhdon në seancat plenare vijuese.

KALENDAR I

2 JAVOR (7 - 17 QERSHOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E Hënë, datë 7.06.2004, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.

Për Votim:

1. P/Ligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave”.

E Martë, datë 8.06.2004

E Mërkurë, datë 9.06.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Rendit (e ka shqyrtuar)

2. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale

3. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2000 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

4. P/Ligji “Për punën e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian” (paraqitur nga deputeti I. Zela).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Integritetit

-Komisioni i Rendit

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

-Komisionet e tjera

5. P/Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

6. P/Ligji “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

7. Shqyrtimi i propozimeve për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Shërbimit Civil.

-Komisioni i Ligjeve

8. Shqyrtimi i propozimeve të Këshillit të Ministrave për anëtar të Komisionit të Konkurrencës.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

9. P/ligji “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 9165, date 23.12.2003 “Per buxhetin e shtetit 2004”.

E Enjte, datë 10.06.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Udhëzimeve dhe Kodit të Procedurave të Nismës së Europës Qendrore (NEQ)”.

2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Periferitë urbane të Tiranës - komponenti i Infrastrukturës”.

3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të

Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe paisja e 5 poliklinikave”.

4. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002 “Për Agjencinë e Trajtit të Kreative”.

5. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”.

6. Dekret nr. 4181, datë 23.03.2004 “Kthimi për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr. 9198, datë 26.02.2004 “Për një shoqëri gjinore të barabartë”.

7. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

8. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

9. Dekret nr. 4188, datë 5.04.2004 “Për kthimin e ligjit nr. 9206, datë 15.03.2004 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9120, datë 28.07.2003”.

10. Shqyrtimi i propozimeve për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Shërbimit Civil.

11. Shqyrtimi i propozimeve të Këshillit të Ministrave për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Konkurrencës.

Për Votim:

1. P/Rezoluta për problemin e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë.

(Vijon në faqen 5)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 4)

E Hënë, datë 14.06.2004, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Mocion për debat me Kryeministrin kërkuar nga Grupi Parlamentar i PDr-së.

E Martë, datë 15.06.2004

E Mërkurë, datë 16.06.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

2. P/Ligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Industrisë

3. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe të privatizimit”, të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Bujqësisë dhe

Ushqimit (e ka shqyrtuar)

4. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë

29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” të ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale

-Komisioni i të Drejtave të

Njeriut

5. P/Ligji “Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mbrojtjes

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacioni

-Komisioni i Shëndetësisë dhe

Mjedisit

E Enjte, datë 17.06.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989”.

2. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”.

3. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2000 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. P/Ligji “Për punën e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian” (paraqitur nga deputeti I. Zela).

5. P/Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.

6. P/Ligji “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar të krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të sanksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP.”

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;

www.ascdpd.org